



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
SENATI AKADEMIK

Nr. 6821 Prot.  
11

Durrës, më 11.04.2023

VENDIM  
Nr 13, datë 11.04.2023

PËR

"MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË PËRBASHKËT (DIPLOMË E DYFISHTË) NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE, DOKTORATË NË "E DREJTË PUBLIKE", PRANË DEPARTAMENTIT TË DREJTËSISË, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës, ME UNIVERSITETIN TOR VERGATA, ROMË, ITALY.

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM Nr.879, datë 16.12.2019 "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" në Udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020, "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësi kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndajen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit të përbashkët (diplomë e dyfishtë) në Ciklin e Tretë të studimeve , Doktoratë në "E Drejtë Publike" pranë Departamentit të Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, me Universitetin Tor Vergata, Romë Itali.
2. Ky Vendim i kalon Bordit të Administrimit për miratimin e tarifës përkatëse.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
  - ✓ Zv. Rektorët
  - ✓ Drejtuesi i Njësisë Kryesore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike
  - ✓ Drejtuesi i Njësisë Bazë pranë Departamentit të Drejtësisë
4. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2023-2024.

*Prof. Dr. Ksenëda SOTIROFSKI*

